

## Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

### Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 28.10-03.11.2024

Janë testuar gjithsej 185 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=218) është shënuar një rënie prej 15,1%.

Pozitive janë 6 raste, me një rënie të numrit nga java e kaluar për 45,5%. Përqindja e rasteve pozitive sillet nga 0,0% deri më 16,7%, mesatarisht 4,4%.

**Tabela 1.** Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 28.10-03.11.2024

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
28.10.2024	40	1	2,5%
29.10.2024	30	2	6,7%
30.10.2024	38	2	5,3%
31.10.2024	32	0	0,0%
01.11.2024	27	0	0,0%
02.11.2024	12	0	0,0%
03.11.2024	6	1	16,7%
Gjithsej	185	6	mesatarja 4,4%

Gjatë javës së kaluar raste janë regjistruar në 2 qytete. Numri më i madh është regjistruar në Shkup (n=5; 83,3%). (Tabela 2).

Raste të reja janë regjistruar tek grupmoshatmbi 50 vjet.

Sipas algoritmit të ri, si të shëruar konsiderohen 12 persona që kanë qenë të shtruar në spital ose në trajtim shtëpiak.

Gjatë javës së kaluar (28.10-03.11.2024), nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

### **GJENDJA KUMULATIVE ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Gjatë vitit 2024, deri më 03.11.2024, janë regjistruar gjithsej 1.733 raste me COVID-19. Në muajin shtator të vitit 2024 (56) regjistrohet një rënie prej 80,6% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024, deri më 03.11.2024, janë testuar gjithsej 12.205 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

## **VLERËSIMI I RREZIKUT**

Pas një periudhe aktiviteti shumë të ulët, detektohet një rritje e aktivitetit të SARS-CoV-2 brenda kontinentit evropian, përfshirë edhe në R. e Maqedonisë së Veriut.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

## **Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll**

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).<sup>1</sup>

**Shkup, 04.11.2024**

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse**

**Instituti i Shëndetit Publik**

---

<sup>1</sup> <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>